



MIRËSEVINI NË FAKULTETIN E EKONOMISË & AGROBIZNESIT

Mirësevini për të vazhduar studimet Tuaja pranë Fakultetit të Ekonomisë & Agrobiznesit! Studimet Tuaja pranë Fakultetit tonë, do t'ju mundësojnë përgatitje dhe arsimim shkencor dhe profesional në fushat e ekonomisë bujqësore, zhvillimit rural të integruar, menaxhimit të ndërmarrjeve, financës, kontabilitetit, marketingut, agroturizmit, ekonomisë dhe politikave agrare të akredituara në sistemin global të edukimit, duke ju dhënë një mundësi të padiskutueshëm për pjesëmarrje aktive në procesin e integrimit evropian të vendit. Arrija e qëllimit të mësipërm do të realizohet nëpërmjet promovimit dhe pjesëmarrjes Tuaj, stafit dhe njësisë akademike të FEA në programe të avancuara të arsimit, kërkimit dhe trajnimit në fushën e ekonomisë dhe agrobiznesit. Shpresojmë që nëpërmjet kesaj fletpalosjeje, të kemi kontribuar sadopak drejt interesave dhe nevojave Tuaja, për një informacion të domosdoshëm dhe orientim të mirë, në fushën e kurrikulave, planeve dhe programeve mësimore dhe jo vetëm, në dobi të familiarizimit me filozofinë e edukimit universitar.

CILI ËSHTË FAKULTETI I EKONOMISË & AGROBIZNESIT

Fakulteti i Ekonomisë & Agrobiznesit (FEA) është një fakultet me një kontributi të rëndësishëm në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ai zë fill që nga viti 1971 (në atë periudhë emërtohej Fakulteti i Ekonomisë Agrare). Ish Fakulteti i Ekonomisë Agrare funksionoi si i tillë deri në vitin 1994, periudhë e cila përkam me ristrukturimin tërësor të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky ristrukturim çoi në fuzionimin e këtij Fakulteti në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë, me dy departamentet përkatëse, Departamenti i "Drejtimit të Fermave dhe Agrobiznesit" dhe Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave Agrare. Ky ristrukturim, i cili filloi në vitin 1994 dhe përfundoi në vitin 1998, u realizua me konsulencën e projektit SARA (American Support for Agricultural Restructuring in Albania) dhe kishte si objektiv themelor përgjigjen ndaj kërkesave të reja që do të ofronte zhvillimi i bujqësisë dhe i sistemit të agrobiznesit në tërësi. Në vitin 2007, si pasojë e ristrukturimit të ish Fakultetit të Bujqësisë, u krijua Fakulteti i Ekonomisë & Agrobiznesit, i cili ka aktualisht gjashtë departamente, Dep. i Drejtimit të Agrobiznesit, Dep. i Ek. & Politikave Agrare, Dep. i Financë Kontabilitetit, Dep. i Menaxhimit të Turizmit Rural, Dep. i Matematikë Informatikës dhe Dep. i Gjuhëve të Huaja.




VIZIONI:

FEA të jetë një qendër bashkëkohore studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive, për t'u bërë pjesë integrale e një bote, ku studentët e diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit të gjejnë veten e tyre dhe të kontribuojnë me dije e profesionalizëm në fushat e ekonomisë bujqësore, zhvillimit rural të integruar, menaxhimit të ndërmarrjeve, financës, kontabilitetit, marketingut, agroturizmit, ekonomisë dhe politikave agrare etj. në dobi të integrimit Evropian.


MISIONI:

FEA, të mundësojë realizimin e edukimit shkencor dhe profesional të studentëve në fushat - vizion i FEA, në nivelin që u mundëson atyre të përballojnë me sukses probleme që lidhen me strategji të menaxhimit të inputeve dhe outputeve në bujqësi, menaxhimin e agrobiznesit, strategji të integrimit të fermerëve në tregje, politika dhe strategji të zhvillimit rural të integruar, politikave agrare etj. nëpërmjet promovimit dhe pjesëmarrjes të studentëve, stafit akademik dhe njësisë të FEA në programe të avancuara të arsimit, kërkimit dhe trajnimit në fushën e ekonomisë dhe agrobiznesit.


NUMRI I STUDENTËVE NË VITE



STAFI AKADEMIK & KUALIFIKIMI




STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT TE EKONOMISE DHE AGROBIZNESIT




PAKETAT E STUDIMEVE QE OFRON FEA

Paketa e studimeve është realizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 datë 22/07/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në insitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".



Programet e studimit të të gjithë niveleve të hartuara me kompetencë nga stafi ynë akademik janë pjesë e një procesi dinamik të veprimtarisë shumëplaneshë të fakultetit. Si të tilla ato ndryshohen dhe përmirësohen vazhdimisht nga ne, duke marrë në konsideratë zhvillimet bashkohore shkencore në fushën e ekonomisë dhe të menaxhimit të agrobiznesit.

NIVELET E STUDIMEVE _ DIPLOMAT, PROFILLET DHE SPECIALITETET QE OFRON FEA SIPAS DEPARTAMENTEVE



MUNDESITE E PUNESIMIT TE STUDENTEVE

- ✚ Në Ministri & Institucione e Tjera Qendrore.
- ✚ Në Institucionet Kërkimore Shkencore.
- ✚ Në Sistemin Bankar.
- ✚ Në Sistemin e Tatim – Taksave.
- ✚ Në Sektorin e Finance-Kontab. të siper marrjeve Private.
- ✚ Në Institucione e Tjera Financiare.
- ✚ Në Agjencitë e Zhvillimit Rural.
- ✚ Në Drejtoritë e Bujqësisë në Qarqe
- ✚ Në Shërbimin Statistikor.
- ✚ Në Ferma & Shoqatat e Fermerëve.
- ✚ Në të Gjitha Nivelet e Pushtetit Lokal.
- ✚ Në Ndërmarrjet e Prodh. & Shpërnd. së Inputeve & Outputeve.
- ✚ Në Arsim
- ✚ Në Ndërmarrjet e Prodhimit & Shpërndarjes së Inputeve.
- ✚ Në Ndërmarrjet e Përpunimit të Ushqimeve për Blegtorinë.
- ✚ Në Industritë e Përpunimit të Produkteve me Origjinë Bimore & Shtazore.
- ✚ Në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
- ✚ Në Shërbim Këshillimor
- ✚ Në Administratat e Komunave, Qarqeve & Prefekturave.
- ✚ Në Ndërmarrje & Subjekte Private etj.

KONTAKT:

FAKULTETI I EKONOMISE & AGROBIZNESIT

Zyra e Karrieres se Studenteve

www.ubt.edu.al



**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI E EKONOMISË & AGROBIZNESIT**

MIRËSEVINI NË FAKULTETIN E EKONOMISË & AGROBIZNESIT



**NE PËRGATISIM SPECIALISTËT E SË ARDHMES PËR
FUSHËN E EKONOMISË DHE MENAXHIMIT TË
AGROBIZNESIT**

